

## AKT – THEMELIMI

### I SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR

### “2F CONSTRUCTION” LTD

Bazuar në ligjin Nr. 9901, dt. 14.04.2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”, me vullnetin e tyre të lirë, të shprehur në nënshkrimin e këtij Akti, sot më date 23 Shtator 2015 themeluesit:

1. **Renido Petritaj**, lindur më 18/09/1990 në Skrapar, identifikuar me Kartën Identiteti me numer Personal \_\_\_\_\_ banues ne adresen: Peze Helmes, Vilat, Tirane, Shqiperi.

#### Deklaron se:

Ka vendosur të nënshkruajnë këtë Kontratë Themelimi, për krijimin e shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar “2F CONSTRUCTION” (LTD), më poshtë referuar si “Shoqëria”.

Veprimtaria e Shoqërisë do të rregullohet nga Akti i Themelimit, Statuti i shoqërisë dhe legjislacioni shqiptar për shoqëritë tregtare.

#### Neni 1 – Emërtimi

Shoqëria emërtohet “2F CONSTRUCTION” LTD. Emërtimi mund të shkruhet me shkronja të mëdha ose të vogla.

#### Neni 2 – Selia

Selia zyrtare e shoqërisë ndodhet në Rrugë Rrugë “Sulejman Delvina” Nr 57, Prane Hotel “Diplomat 1”, Kat 2, Ap. Nr. 5, Njesia nr. 5, Tirane, Shqiperi.

Shoqëria, sipas parashikimeve të Statutit dhe legjislacionit në fuqi, mund të hap si në Shqipëri ashtu edhe jashtë saj, përfaqësi, filiale, degë dhe shoqëri të tjera.

#### Neni 3 – Kohëzgjatja

Kohëzgjatja e veprimtarisë së Shoqërisë do të jetë pa afat, duke filluar prej datës së regjistrimit të saj në Regjistrin e Shoqërive Tregtare pranë Qëndrës Kombëtare të Regjistrimit. Ky afat mund të ndryshohet një ose më shumë herë, me vendim të Asamblesë së Ortakeve.

#### Neni 4 – Objekti

2.1 Shoqëria “2F CONSTRUCTION” LTD, ka si objekt të veprimtarisë tregtare së saj, por pa u kufizuar:

ne fushen e Ndertimeve te Ndryshme

2.2 Shoqeria ka per objekt te tjera te veprimtarise se saj:

ne fushen e tregetimit me pakice dhe shumice, importi dhe eksporti te : veshmbathje, konfeksione, hidrosanitare, hidraulike, elektreike, detergjente, artikuj tualeti dhe kozmetike, kancelari per zyra dhe shkolla, orendi shtepiake, mobilje, paisje elektrike, elektronike e elektroshtepiake, fruta perime, artikuj industrial ushqimor dhe blegtoral, bime medicianle e etero-vajore, pije te ndryshme alkoolike e freskuese, automjete te te gjitha llojeve, transport per vete dhe per te tjeret, prodhim dhe tregetim te materialeve dyeralumini, plastike dhe druri, dyer e dritare shkollore etj, pjese kembimi per makina e automjete, goma e bateri, pike servisi.

Te zvilloj aktivitet ne fushen e shfrytezimit dhe nxjerjes se mineraleve te ndryshme ( krom etj) nga punimet nentoksore dhe siperfaqsore ( karrierat ).

Tregtimin, transportin dhe perdorimin e lendet plasese qe sherben per punen ne miniere. Shoqeria mund te realizojë çdo llojë operacioni financiar apo tregtar, që lidhet direkt apo indirekt me objektin e saj, akt-marrveshje me palë të treta brënda limiteve të parashikuara nga legjislacioni në fuqi.

Shoqeria me qellim te arritjes se objektivave te saj mund te marre persiper si direkt ashtu edhe indirekt, pjesmarrje ne fitime e pjesmarrje ne shoqeri te tjera shqiptare ose te huaja qe kane objekt te njejtë ose te ngjashem me objektin e saj.

Gjithashtu, Shoqeria gjate aktivitetit te saj ka te drejte te perdore marken e vet tregetare, te beje marketingun e prodhimeve dhe sherbimeve te saj si ne vend ashtu edhe jashte tij.

#### **Neni 5 – Kapitali i regjistuar**

Kapitali i regjistruar i Shoqërisë është 100 lekë (nje qind). Kapitali i regjistruar është i përbërë nga 1 kuote kapitali me vlerë nominale 100 (njëqind) lekë secila, të gjitha të nënshkruara e të paguara. Kuotat e nënshkruara të kapitalit janë shlyer tërësisht nga themeluesit.

#### **Neni 6 – Kuotat e kapitalit të Regjistruar**

Sipas kontributeve në kapitalin e regjistruar të Shoqërisë kuotat ndahen:

1. Renido PETRITAJ 100 % të kapitalit.

#### **Neni 7 – Kuotat dhe kalimi i kuotave të kapitalit**

Zotërimi i kuotave, mënyra e fitimit dhe kalimit të kuotave, pjestimi dhe transferimi i tyre do të bëhen sipas procedurave të parashikuara në ligjin Nr. 9901, dt. 14.04.2008 “Për tregtarët dhe Shoqërítë tregtare” dhe nga Statuti i Shoqërisë.

#### **Neni 8 – Administrimi**

Administratori i parë i Shoqërisë është **Z. Renido PETRITAJ** i cili do te qendroje ne detyre per një periudhe 5 vjecare me te drejte rizgjedhjeje.

Ai do të ndjek të gjitha procedurat e nevojshme për regjistrimin e Shoqërisë në Qëndrën Kombëtare të Regjistrimit (QKR).

Të gjitha shpenzimet, që do kryhen deri në regjistrimin e Shoqërisë si Person Juridik, do të përfshihen në bilancin e Shoqërisë.



### **Neni 9 – Të tjera**

Shoqëria do ta ushtrojë veprimtarinë e saj sipas legjislacionit shqiptar. Kushtet e punës, shpërblimet, oraret, pushimet dhe sigurimet shoqërore të personelit do të rregullohen nga kontrata kolektive ose ajo individuale e punës, si dhe nga legjislacioni shqiptar në fuqi.

### **Neni 10**

Të gjitha kundërshtimet ose mosmarrveshjet, që mund të lindin, gjatë ushtrimit te aktivitetit të Shoqërisë ose gjatë likujdimit të saj, midis ortakeve ose një ose më shumë ortakeve dhe Shoqërisë, do të diskutohen në mënyrë të drejtpërdrejtë midis të interesuarve për t' i zgjidhur miqësisht. Në rast të kundërt i nënshtronen jurksionit të gjykatave kopetente në kushtet e parashikuara nga legjislacioni shqiptar në fuqi.

### **Neni 11**

Ky Akt Themelimi është përgatitur në katër kopje me vlerë te njejte juridike.

### **ORTAKU THEMELUES**

**RENIDO PETRITAJ**

